



UNMIK/REG/2007/29
4 tetor 2007

REGULLORE NR. 2007/29

MBI

**NDRYSHIMET NË KORNIZËN KUSHTETUESE PËR VETËQEVERISJE
TË PËRKOHSHMENË KOSOVË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP),

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë sipas Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) nr. 1999/1, të datës 25 korrik 1999, mbi autotorizimet e Administratës së përkohshme në Kosovë dhe Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisaje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Duke vepruar në pajtim me nenin 14.3 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë,

Me qëllim të ndryshimit të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9, e datës 15 maj 2001),

Përmes kësaj Rregulloreje shpall:

Neni 1
Ndryshimet

Duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9) ndryshohet si në vijim:

1.1 Në nenin 9.1.2, fjalët “në bazë të listës së hapur” futen pas fjalës “fletëvotim”

1.2 Neni 9.1.3 (b) (ii) ndryshohet në: “Dhjetë (10) vende ndahen për komunitetet e tjera si në vijim: komuniteti rom – një (1) vend; komuniteti ashkali – 1 (një) vend; komuniteti egjiptian – një (1) vend dhe një vend ndahet qoftë për komunitetin rom, ashkali apo atë egjiptas, bazuar në atë se cili komunitet ka marrë më shumë vota të vlefshme; komuniteti boshnjak – tri (3) vende; komuniteti turk – dy (2) vende dhe komunitetit goran – një (1) vend.”

1.3 Neni 9.1.3 (c) ndryshohet si në vijim:

“Secili person që i ka mbushur 18 vjet në ditën e zgjedhjeve të caktuara, i cili:

- (i) është i regjistruar si banor i përhershëm i Kosovës apo
- (ii) që është duke banuar jashtë Kosovës ose që ka dalë më 1 janar 1998 ose pas kësaj date, dhe që i përmbush kriteret për t’u regjistruar si banor i përhershëm në Kosovë ose
- (iii) ka fituar statusin e refugjatit, ashtu siç është i përcaktuar në Konventën lidhur me statusin e refugjatit të datës 28 korrik 1951 dhe në Protokollin e saj të datës 16 dhjetor 1966 më 1 janar 1998 apo pas kësaj date, dhe që i plotëson kriteret për t’u regjistruar si banor i përhershëm i Kosovës,

ka të drejt të votojë në zgjedhjet në Kosovë në përputhje me ligjin në fuqi”

1.4 Neni 9.1.3 (d) shlyhet dhe paragrafëve vijues u vihen numrat sipas renditjes së duhur.

1.5 Në nenin 9.1.4 fjala “tre” zëvendësohet me fjalën “katër.”

1.6 Në nenin 9.2.3 fjala “tre” zëvendësohet me fjalën “katër.”

Neni 2 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 4 tetor 2007 2007.

Joachim Rücker
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përhershëm